Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

02-060/01-0055100-13/26
24.09.2026

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0055100-13/26 dt. 24.09.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, alineja b, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008), nenin 18, të Ligjit Nr. 06/L-092 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (GZ Nr. 10/03, prill 2019) dhe neni 18 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e p[procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe 15, të Statutit të Komunës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 24.09.2026 pasi shqyrtoi Propozim vendimin e Kryetarit të Komunës Nr. 02-020/04-0054960/26 dt. 15.09.2026 me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0053079-13/26, dt. 15.09.2026), sjell këtë:

VENDIM
Për formimin e Komisionit të Ankesave (për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës)

1. Me këtë Vendim FORMOHET Komisioni i Ankesave i cili do të shqyrtojë ankesat të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, në këtë përbërje:
   1.1 Xhevdet Osmani - nga Kuvendi i Komunës,
   1.2 Sazan Ramaxhiku - nga Kuvendi i Komunës,
   1.3 Arjeta Beqiri Hyseni - nga ekzekutivi i Komunës,
   1.4 Nazmi Kelmendi nga ekzekutivi i Komunës, dhe
   1.5 Lulzim Hakaj - anëtar nga sektori jo qeveritar.
2. Komisioni është përgjegjës të Shqyrtoi ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës. Komisioni bazë për punën e tij e ka Ligjin Nr. 06/L–092, Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi nga fusha përkatëse.
3. Administrata e Komunës i ofron përkrahje Komisionit të Ankesave, sipas kërkesës së tyre.
4. Mandati i anëtarëve të Komisionit është dy (2) vjeçar, brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komisioni i emëruar me këtë vendim.
6. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Sait KAMBERI

Dorëzohet:
1 x 1 **Kryesuesit të Kuvendit**
1 x 1 **MAPL**
1 x 1 **Arkivit**
Kopje: **Kryetarit të Komunës**
Anëtarëve të Komisionit